

**VENDIM**  
**Nr. 46, datë 1.9.2021**

**PËR NJË NDRYSHIM NË RREGULLOREN “PËR RAPORTIN E MBULIMIT  
ME LIKUIDITET”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c”, të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 26, pika 1, shkronja “a” dhe nenit 66, të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006, “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për raportin e mbulimit me likuiditet”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 27, datë 28.3.2019, të bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

2. Në nenin 4, pika 2, përmbajtja e shkronjës “f” ndryshon si vijon:

*“f) “monedhë e rëndësishme” – është çdo monedhë, në të cilën detyrimet e denominuara dhe të pagueshme në këtë monedhë përbëjnë të paktën 5% të detyrimeve totale të bankës, duke përjashtuar zërat e kapitalit dhe zërat jashtë bilancit;”.*

3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes dhe Departamenti i Statistikave Financiare të Bankës së Shqipërisë për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

4. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**  
**Gent Sejko**